



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 234

Tiranë – E premte, 2 dhjetor 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 30, datë 24.11.2016	Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Alb Credit”..... 24249
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 31, datë 24.11.2016	Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Alb-Progres”..... 24249
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 32, datë 24.11.2016	Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Fed Invest”..... 24250
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 33, datë 24.11.2016	Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”..... 24250
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 34, datë 24.11.2016	Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Petrela”..... 24251
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 35, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Dobresh”..... 24251
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 36, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”..... 24252
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 37, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Jubë”..... 24253

Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 38, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Hamallaj”.....	24254
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 39, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred”.....	24255
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 40, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Perlat”.....	24256
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 41, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Pinarë”.....	24257
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 42, datë 24.11.2016	Për refuzimin e kërkesës për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona”.....	24258
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 6200/3, datë 3.11.2016	Për shpronësim me interes publik të pasurisë të paluajtshme të tipit “arë”, që preket nga “Ndërtimi i nënstacionit 110KV Orikum dhe nënstacionit 110KV Himarë”.....	24259
Shkurtim vendimi i Dhomës së Noterëve nr. 2665, datë 25.11.2016	Për emërimin e kujdestarit Ilia Ligor Tili për pasuritë e Sotir (Sotiraq) Ndili mbështetur në nenin 344 të Kodit Civil (i ndryshuar).....	24260



## VENDIM

Nr. 30, datë 24.11.2016

**PËR DHËNIEN E VËRTETIMIT PËR  
PLOTËSIMIN E KËRKESAVE LIGJORE  
DHE NËNLIGJORE LIDHUR ME  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE, SI DHE  
CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË  
DEPOZITAVE SHOQËRISË SË KURSİM-  
KREDITIT “ALB CREDIT”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm,

## VENDOSI:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Alb Credit”.

2. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

3. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për dorëzimin e vërtetimit dhe certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “Alb Credit”.

4. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Alb Credit”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

**KRYETAR  
Donald Duraj**

## VENDIM

Nr. 31, datë 24.11.2016

**PËR DHËNIEN E VËRTETIMIT PËR  
PLOTËSIMIN E KËRKESAVE LIGJORE  
DHE NËNLIGJORE LIDHUR ME  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE, SI DHE  
TË CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË  
DEPOZITAVE SHOQËRISË SË KURSİM-  
KREDITIT “ALB-PROGRES”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm,

## VENDOSI:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “ALB-Progres”.

2. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

3. Ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për prodhimin e certifikatës.

4. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për dorëzimin e vërtetimit dhe certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “ALB-Progres”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “ALB-Progres”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

**KRYETAR  
Donald Duraj**



## VENDIM

Nr. 32, datë 24.11.2016

**PËR DHËNIEN E VËRTETIMIT PËR  
PLOTËSIMIN E KËRKESAVE LIGJORE  
DHE NËNLIGJORE LIDHUR ME  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE, SI DHE  
CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË  
DEPOZITAVE SHOQËRISË SË KURSİM-  
KREDITIT “FED INVEST”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm,

## VENDOSI:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Fed Invest”.

2. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

3. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për dorëzimin e vërtetimit dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Fed Invest”.

4. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Fed Invest”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

**KRYETAR  
Donald Duraj**

## VENDIM

Nr. 33, datë 24.11.2016

**PËR DHËNIEN E VËRTETIMIT PËR  
PLOTËSIMIN E KËRKESAVE LIGJORE  
DHE NËNLIGJORE LIDHUR ME  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE, SI DHE  
TË CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË  
DEPOZITAVE SHOQËRISË SË KURSİM-  
KREDITIT “PARTNER PLUS”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm,

## VENDOSI:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”.

2. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

3. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për dorëzimin e vërtetimit dhe certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”.

4. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

**KRYETAR  
Donald Duraj**



## VENDIM

Nr. 34, datë 24.11.2016

**PËR DHËNIEN E VËRTETIMIT PËR  
PLOTËSIMIN E KËRKESAVE LIGJORE  
DHE NËNLIGJORE LIDHUR ME  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE, SI DHE TË  
CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË  
DEPOZITAVE SHOQËRISË SË KURSIM-  
KREDITIT “PETRELA”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm,

## VENDOSI:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Petrela”.

2. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

3. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për dorëzimin e vërtetimit dhe certifikatës së sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Petrela”.

4. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Petrela”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

**KRYETAR  
Donald Duraj**

## VENDIM

Nr. 35, datë 24.11.2016

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR  
ANËTARËSIM NË SKEMËN E  
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË  
SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT  
“DOBRESH”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Dobresh”,

## VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Dobresh” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 14 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Dobresh”:

a) nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar sipas programit të punës apo të kërkuara gjatë verifikimit mbi depozitat dhe depozituesit, drejtimin e shoqërisë ose gjendjen financiare;

b) mungonte sistemi informatik për mbajtjen e të dhënave, raportimin e tyre dhe përlllogaritjen e primit;

c) ambientet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e



veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare;

ç) mungonte moduli i kontabilitetit;

d) mungonte stafi i punësuar dhe Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme nuk kishin kryer asnjë mbledhje gjatë vitit 2016;

dh) komiteti i kontrollit nuk kishte kryer asnjë veprim mbi aktivitetin e shoqërisë.

4. Nisur nga gjetjet e verifikimit të datës 14 korrik 2016, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. prot. 5173, datë 3.10.2016, “Mbi marrjen e masave mbikëqyrëse për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore nga Shoqëria e Kursim-Kreditit “Dobresh”, vendosi të pezullojë aktivitetin kredidhënës dhe depozitues të këtij subjekti.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

#### VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Dobresh” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Dobresh”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Dobresh” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

#### VENDIM

Nr. 36, datë 24.11.2016

### PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “FUSHAS–MUMAJES”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për

sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pikat 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”,

#### VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 4 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë, kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”:

a) nuk kishte pajisje informatike dhe mbështetje në sistemin informatik të shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” në të cilin mungonte moduli për llogaritjen e primit, si dhe nuk mundësohej prodhimi i skedarëve për raportim në Agjenci;

b) në të dhënat identifikuese të depozituesve kishte mangësi;

4. Gjendja financiare e shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” ishte e paverifikueshme për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

5. Strukturat drejtuese nuk ishin në përputhje me kërkesat ligjore për sa i përket përbërjes dhe funksionimit.

6. Ambientet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare.

7. Në vijim të verifikimit të datës 4 korrik 2016 shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” iu rekomandua:

a) ndërtimi i modulit elektronik për llogaritjen e primit të sigurimit të depozitave;



b) përgatitja e skedarëve me të dhënat mbi depozitat dhe depozituesit për t'u raportuar elektronikisht në Sistemin për Raportim dhe Kompensim;

c) plotësimi dhe saktësimi i të dhënave të depozitave dhe depozituesve;

ç) informimi i strukturave drejtuese dhe punonjësve në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave;

d) pasqyrimi real i transaksioneve me depozitat në sistemin elektronik të shoqërisë së kursim-kreditit bazuar në dokumentacionin justifikues;

dh) garantimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave drejtuese në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

e) përshtatja e zyrave për kryerjen e një aktiviteti financiar në përputhje me aktet rregullative në fuqi;

ë) zgjidhja e mosmarrëveshjeve me Unionin Shqiptar të Shoqërive të Kursim-Kreditit mbi të drejtat detyrimet përkatëse.

8. Afatet për përmbushjen e rekomandimeve u dakordësuan të ndryshme, por për çështjet me prioritet ato ishin menjëherë dhe shtator 2016.

9. Grupi i verifikimit të Agjencisë kreu verifikimin përfundimtar në datën 17 tetor 2016, mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”. Nga ky verifikim u konstatua se:

a) nuk ishte implementuar moduli për përlogaritjen e primit;

b) sistemi elektronik nuk mundësonte prodhimin e skedarëve për raportim;

c) ambientet ishin duke u plotësuar në përputhje me kërkesat rregullatore gjatë procesit të verifikimit;

ç) aktet e brendshme të shoqërisë ishin rishikuar, por nuk përputheshin me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

d) punonjësit nuk kishin njohuri për skemën e sigurimit të depozitave;

e) shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” kishte nënshkruar një deklaratë noteriale me Unionin Shqiptar të Shoqërive të Kursim-Kreditit, për njohjen e detyrimit prej 8 (tetë) milionë lekësh. Kjo shumë që nuk është pasqyruar në bilancin e muajit shtator 2016, do ta bënte kapitalin e shoqërisë së kursim-kreditit negativ.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

VENDIM

Nr. 37, datë 24.11.2016

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR  
ANËTARËSIM NË SKEMËN E  
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË  
SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT  
“JUBË”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Jubë”,

VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.



2. Shoqëria e kursim-kreditit “Jubë” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 11 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Jubë”:

a) nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar sipas programit të verifikimit apo të kërkuara gjatë procesit të verifikimit mbi depozitat dhe depozituesit, drejtimin e shoqërisë ose gjendjen financiare;

b) mungonte sistemi informatik për mbajtjen e të dhënave, raportimin e tyre dhe përlllogaritjen e primit;

c) ambientet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare;

ç) mungonte moduli i kontabilitetit;

d) mungonte stafi i punësuar dhe Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme nuk kishin kryer asnjë mbledhje gjatë vitit 2016;

dh) komiteti i kontrollit nuk kishte kryer asnjë veprim mbi aktivitetin e shoqërisë.

4. Nisur nga gjetjet e verifikimit të datës 11 korrik 2016, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. prot. 5173, datë 3.10.2016, “Mbi marrjen e masave mbikëqyrëse për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore nga Shoqëria e Kursim-Kreditit “Jubë””, vendosi të pezullojë aktivitetin kredidhënës dhe depozitues të këtij subjekti.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

#### VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Jubë” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Jubë”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së

kursim-kreditit “Jubë” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

#### VENDIM

Nr. 38, datë 24.11.2016

#### PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “HAMALLAJ”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Hamallaj”,

#### VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Hamallaj” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datën 11 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Hamallaj”:

a) nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar sipas programit të punës apo të kërkuara gjatë verifikimit mbi depozitat dhe depozituesit, drejtimin e shoqërisë ose gjendjen financiare;





b) mungonte sistemi informatik për mbajtjen e të dhënave, raportimin e tyre dhe përlogaritjen e primit;

c) ambientet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare;

ç) mungonte moduli i kontabilitetit;

d) mungonte stafi i punësuar dhe Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme nuk kishin kryer asnjë mbledhje gjatë vitit 2016;

dh) komiteti i kontrollit nuk kishte kryer asnjë veprim mbi aktivitetin e shoqërisë.

4. Nisur nga gjetjet e verifikimit të datës 11 korrik 2016, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. prot. 5173, datë 3.10.2016, “Mbi marrjen e masave mbikëqyrëse për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore nga Shoqëria e Kursim-Kreditit “Hamallaj””, vendosi të pezullojë aktivitetin kredi dhënës dhe depozitues të këtij subjekti.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

#### VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Hamallaj” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Hamallaj”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Hamallaj” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

**KRYETAR**  
**Donald Duraj**

#### VENDIM

**Nr. 39, datë 24.11.2016**

#### **PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “NEW CRED”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pikat 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “New Cred”,

#### VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “New Cred” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datat 6–8 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët në shoqërinë e kursim-kreditit “New Cred”, u konstatua se:

a) në skedarët për raportim pranë Agjencisë kishte mungesa të fushave thelbësore dhe të fushave të detyrueshme për identifikimin e depozituesve, interesi ditor nuk përfshihej në balancën e agreguar, si dhe nuk kryhej konvertimi automatik i balancave në valutë.

b) nga 5027 depozitues që rezultuan në datë 5 korrik 2016, 1562 prej tyre nuk kishin dokument identifikimi, 640 nuk kishin numër personal, 900 depozituesve iu mungonte adresa, si dhe 1121



depozituesve iu mungonte numri i telefonit.

c) rreth 4000 depozitues kishin mungesa të theksuara në të dhënat identifikuese. Depozitat e këtyre depozituesve ishin klasifikuar si “depozita inaktive” dhe nuk janë raportuar në Agjenci në raportimet e mëparshme me kërkesë të Agjencisë.

ç) moduli i primit nuk e kryente saktë llogaritjen e tij;

d) paralelisht me strukturat drejtuese të SHKK-së “New Cred” funksiononin edhe strukturat drejtuese të degëve të saj;

dh) depozitat nuk kontabilizoheshin në të njëjtën mënyrë.

4. Në vijim të verifikimit të datave 6–8 korrik 2016, shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred” iu rekomandua të merrte masa për plotësimin e mangësive, për të cilat u lanë afate të ndryshme duke filluar nga muaji shtator 2016 e deri në fund të vitit 2016.

5. Nga verifikimi përfundimtar i datës 20 tetor 2016 mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna, grupi i verifikimit të Agjencisë konstatoi se:

a) sistemi elektronik mundësonte gjenerimin e skedarëve për raportim pranë Agjencisë, por plotësimi i fushave dhe formatimi i tyre nuk ishte në përputhje me formatin standard të skedarëve;

b) sistemi elektronik mundëson llogaritjen e primit, por moduli i llogaritjes së primit ende gjeneron pasaktësi;

c) nuk u mundësua gatishmëria e sistemit dhe për këtë arsye ishte e pamundur një kontroll i mirëfilltë i cilësisë së të dhënave;

ç) depozituesit me probleme në cilësinë e të dhënave ishin kontabilizuar si “detyrime të tjera”. Me vendim datë 25 shtator 2016, të Këshillit Drejtues të SHKK-së “New Cred”, ishin përjashtuar nga anëtarësia mbi 4000 depozitues. Ky vendim nuk kishte të bashkëlidhur një listë emërore të këtyre depozituesve. Vlera e depozitave sipas listës që iu vu në dispozicion grupit të verifikimit, nuk përputhej me lëvizjet kontabël në zërat përkatës të bilancit të raportuar;

d) numri i degëve të raportuara pranë Agjencisë nuk përputhej duke variuar nga 12–19 degë;

ë) për përmbushjen e disa prej rekomandimeve të tjera të shprehura në raportin e verifikimit, shoqëria e kursim-kreditit “New Cred” ishte ende në pritje të një versioni të ri të sistemit elektronik, i cili më datë 20 tetor 2016 nuk kishte përfunduar ende.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “New Cred” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “New Cred” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

VENDIM

Nr. 40, datë 24.11.2016

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR  
ANËTARËSIM NË SKEMËN E  
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË  
SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT  
“PERLAT”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Perlat”,

VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës



së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Perlat” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 12 korrik 2016 grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Perlat” përdorte një sistem elektronik në të cilin:

a) të dhënat për depozitat dhe depozituesit kishin mangësi;

b) nuk mundësohej llogaritja e primit pasi nuk ishte implementuar moduli për llogaritjen e tij;

c) nuk mundësohej gatishmëria e përpunimit të të dhënave mbi depozitat dhe depozituesit në rast ngjarjeje sigurimi.

4. Gjendja financiare e shoqërisë së kursim-kreditit “Perlat” nuk mund të verifikohet për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

5. Strukturat drejtuese nuk ishin në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi për sa i përket përbërjes dhe funksionimit.

6. Punonjësit e shoqërisë së kursim-kreditit “Perlat” nuk kishin njohuri mbi skemën e sigurimit të depozitave.

7. Në vijim të verifikimit të datës 12 korrik 2016 shoqërisë së kursim-kreditit “Perlat” iu rekomandua:

a) ndërtimi i modulit elektronik për llogaritjen e primit të sigurimit të depozitave;

b) përgatitja e skedarëve me të dhënat mbi depozitat dhe depozituesit për t’u raportuar elektronikisht në sistemin për raportim dhe kompensim;

c) plotësimi dhe saktësimi i të dhënave të depozitave dhe depozituesve;

ç) informimi i strukturave drejtuese dhe punonjësve në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave;

d) pasqyrimi real i transaksioneve dhe pasqyrate financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) garantimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave drejtuese në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

8. Afatet për përmbushjen e rekomandimeve u dakordësuan të ndryshme, por për çështjet me prioritet ato ishin shtator, tetor 2016.

9. Në datën 21 tetor 2016, grupi i verifikimit të Agjencisë kreu verifikimin përfundimtar mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga shoqëria e kursim-kreditit “Perlat”. Nga ky verifikim u konstatua se:

a) ishte implementuar moduli për përllogaritjen e primit, por formula e përllogaritjes nuk ishte e saktë;

b) sistemi elektronik mundësohte prodhimin e skedarëve për raportim, por formati i të dhënave kishte pasaktësi;

c) nuk garantohet gjendja financiare e qëndrueshme pasi nuk rakordonin shifrat për depozitat ndërmjet inventarit nga sistemi informatik dhe bilanceve. Për disa zëra në bilanc me vlerë të konsiderueshme nuk kishte asnjë dokument justifikues.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Perlat” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Perlat”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Perlat” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

VENDIM

Nr. 41, datë 24.11.2016

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR  
ANËTARËSIM NË SKEMËN E  
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË  
SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT  
“PINARË”**

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja



“p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë”,

#### VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 14 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë”:

a) nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar sipas programit të verifikimit apo të kërkuara gjatë procesit të verifikimit mbi depozitat dhe depozituesit, drejtimin e shoqërisë ose gjendjen financiare;

b) mungonte sistemi informatik për mbajtjen e të dhënave, raportimin e tyre dhe përlogaritjen e primit;

c) ambjentet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare;

e) mungonte moduli i kontabilitetit;

d) mungonte stafi i punësuar dhe Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme nuk kishin kryer asnjë mbledhje gjatë vitit 2016;

dh) komiteti i kontrollit nuk kishte kryer asnjë veprim mbi aktivitetin e shoqërisë.

4. Nisur nga gjetjet e verifikimit të datës 14 korrik 2016, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. prot. 5173, datë 3.10.2016, “Mbi marrjen e masave

mbikëqyrëse për shkeljen e akteve ligjore dhe nënligjore nga Shoqëria e Kursim-Kreditit “Pinarë”, vendosi të pezullojë aktivitetin kredidhënës dhe depozitues të këtij subjekti.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

#### VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Pinarë” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Pinarë”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Pinarë” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

#### VENDIM

Nr. 42, datë 24.11.2016

### PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “TIRONA”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Tirona”,



## VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Tirona” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 4 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët në shoqërinë e kursim-kreditit “Tirona”, u konstatua se:

a) në sistemin informatik mungonte moduli për llogaritjen e primit;

b) mungonin të dhëna të sakta për depozitat dhe depozituesit;

c) mungonte dokumentacioni i domosdoshëm për mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve për hapjen dhe transaksionet financiare me depozitat.

4. Gjendja financiare e shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” ishte e paverifikueshme për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

5. Mungonte tërësisht dokumentacioni për funksionimin e strukturave drejtuese.

6. Shoqëria e kursim-kreditit “Tirona” ishte në konflikt gjyqësor me Union Shqiptar të Kursim-Kredisë lidhur me të drejtat dhe detyrimet përkatëse si pasojë e shkëputjes së kësaj shoqërie nga Unioni.

7. Në vijim të kërkesës së shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” pranë Bankës së Shqipërisë dhe pretendimit mbi përmbyshjen e kushteve, grupi i verifikimit në datën 14 tetor 2016, kreu një proces tjetër verifikimi. Në përfundim të këtij procesi u konstatua se problematikat ishin të njëjta me ato të evidentuara në verifikimin e datës 4 korrik 2016.

8. Në muajin gusht 2016, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ishin regjistruar katër urdhra për vendosjen e sekuestros konservative mbi shoqërinë e kursim-kreditit “Tirona” nga kompani përmbarimore.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

## VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Tirona” nuk përmbysh kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR  
Donald Duraj

## KËRKESË

Nr. 6200/3, datë 3.11.2016

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurisë të paluajtshme të tipit “arë”, që preket nga “Ndërtimi i nënstacionit 110KV Orikum dhe nënstacionit 110KV Himarë”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për pronarin e pasurisë nr. 998/23 dhe pronarin e pasurisë nr. 998/24, në zonën kadastrale 3621, sipas tabelës bashkëlidhur.

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personi që ka emrin në listën emërore ka të drejtën të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

ZËVENDËSMINISTRI I ENERGISË  
DHE INDUSTRIË  
Ilir Bejtja



LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë Arë

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësimit për nënstacionin m <sup>2</sup>	Vlera e shpronësimit në lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m <sup>2</sup>				
Bashkia Vlorë											
Tragjas											
1	Merushë		Harizaj	3621	998/23	Arë	2046	1723.2	204	351533.0	
2	Krenar		Harizaj	3621	998/24	Arë	2046	75.69	204	15441.0	Bashkëpronësi
Sipërfaqe totale për shpronësimi në m <sup>2</sup>								1798.89			
Shuma totale në lekë për shpronësim										366974	

**SHKURTIM VENDIMI  
Nr. 2665, datë 25.11.2016**

Sot, në datën 25.11.2016, ditën e premte, unë noter Afërdita Vladimir Molla, anëtar i Dhomës së Noterëve Korçë, që kryej veprimtarinë si noter në zyrën që ndodhet në qytetin e Korçës, në rrugën “6 Dëshmorët”, më 29 gusht 2016, kam marrë vendimin me nr. 2665 të repertorit e 1823 të koleksionit, me anën e të cilit, ndër të tjera, është vendosur:

- z. Ilia Ligor Tili, me banim në qytetin e Korçës, në bulevardin “Republika” emërohet kujdestar i çdo pasurie të paluajtshme të njohur apo kthyer me anën e vendimit nr. 1490, datë 14.6.1996, në emër të trashëgimlënësit Sotir (Sotiraq) Vasil Ndili, kaluar mbas vdekjes së tij te trashëgimtarët Theodhora Ndili, Gjergji Ndili e Zhaneta Ndili, prona këto ndodhur në qytetin e Korçës.

- Kujdestari të tërheqë çdo dokument prej zyrove përkatëse me anën e të cilave vërtetohen të drejta pronësie apo të drejta të tjera mbi pasuritë e trashëgimtarëve të Sotiraq (Sotir) Ndili kaluar te trashëgimtarët e tij. Pasqyrën përmbledhëse të dokumenteve t’ia paraqesë noterit. Kjo pasqyrë do të jetë shtojcë e një akt

inventari ose pjesë përbërëse e tij që do t’i paraqitet noterit.

- Të kryejë një vlerësim çmues të sendeve në pronësi të Sotir (Sotiraq) Ndili kaluar te trashëgimtarët e tij prej një eksperti të fushës e aktin përkatës t’ia paraqesë noterit.

- Të hartojë vetë një pasqyrë, me anën e së cilës të vërtetohet çdo lloj shpenzimi gjyqësor apo administrativ për pasuritë e Sotir (Sotiraq) Ndili kaluar te trashëgimtarët e tij, si dhe çdo detyrim tjetër që rëndon mbi këto pasuri apo pjesë e tyre.

- Të ngrejë padi ndaj çdo personi fizik apo juridik që mëton të drejta mbi pasuritë e Sotir (Sotiraq) Ndili kaluar te trashëgimtarët e tij. Të paraqesë prapësime ndaj çdo lloj padie që ngrenë të tretët mbi këto pasuri.

- Çdo e ardhur, që mund të vijë prej pasurive të Sotir (Sotiraq) Ndili, duhet të depozitohet në bankë prej kujdestarit duke çelur për këtë qëllim një llogari të veçantë.

- Të ekzekutojë çdo detyrim lidhur me legët e barrët.

NOTER  
Afërdita Vladimir Molla

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë